

UDHËZIM
Nr.2, datë 29.6.2010

PËR DOKUMENTACIONIN E DOMOSDOSHËM PËR TË KËRKUAR LEJE
MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutes dhe në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”,

UDHËZOJ:

1. Për t’u pajisur me leje mjedisore për veprimtaritë me ndikim në mjedis, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, përgatisin dokumentet që kërkohen nga ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.249, datë 24.4.2003 “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore”.

2. Dokumentet për t’u pajisur me leje mjedisore konsistojnë në:

2.1 Kërkesën nga propozuesi, për t’u pajisur me leje mjedisore, për projektin apo veprimtarinë që do të ushtrohet drejtuar Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL). Kërkesa përmban informacionin e formularit përkatës së Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe plotësohet pranë QKL-së në momentin e aplikimit për leje mjedisore.

2.2 Dokumentacionin ligjor që përbëhet nga:

a) Fotokopje e noteruar e regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.3 Dokumentacioni teknik (përshkrimi i aktivitetit, skica, harta etj.) që përbëhen nga:

a) Karakteristikat e projektit:

i) përshkrimi i teknologjisë, proceseve kryesore, kapaciteti, lëndët e para, energjia, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;

ii) program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;

iii) aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (p.sh.rrugë të reja, sigurim i ujit të pijshëm etj.).

a) Vendndodhja e projektit:

i) planimetria me kufijtë hapësinorë të projektit;

ii) harta dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;

iii) planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.

c) Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis të hartuar nga ekspertë të certifikuar e të përzgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore. Raportet e VNM-së të firmosen dhe vulosen nga hartuesit, si dhe të jepen të dhënat e licencës së ekspertëve të mjedisit të certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (emrin, numrin e regjistrimit, datën e miratimit dhe numrin e vendimit të certifikatës).

d) Informacion me të dhëna të konsultimit me publikun dhe palët e interesuara. Bashkëngjitur informacionit të jenë procesverbale të takimeve, materialet e prezantuara, lista e personave të pranishëm, foto, që provojnë komunikimet e kërkuesit me publikun e zonës.

e) Deklaratë e përgatitur nga kërkuesi, ku evidentohen kërkesat apo pretendimet e paraqitura nga publiku, OJF-të lokale (OJF-të që veprojnë në nivel kombëtar për projekte kombëtare), përfaqësues të pushtetit vendor, apo palë të tjera të interesuara të ngritura gjatë prezantimit të veprimtarisë në kuadër të konsultimeve me publikun, si dhe sugjerimet dhe masat që do të merren parasysh nga subjekti.

f) Plani i rehabilitimit për veprimtaritë që shfrytëzojnë burimet minerare (karrierat lumore dhe zhuret). Plani i rehabilitimit hartohet sipas kërkesave të vendimit nr.3, datë 21.6.2006 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për rehabilitimin e shtretërve dhe të brigjeve të lumenjve, të dëmtuara

nga shfrytëzimi i inerteve”, si dhe udhëzimit nr.3, datë 17.5.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”.

g) Plani i përballimit të emergjencave për veprimtaritë që përdorin, prodhojnë dhe magazinojnë (depozitim) lëndë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve (si karburantet) apo substancat dhe preparatet e përshkruara në nenin 5 të ligjit nr.9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”. Plani i përballimit të emergjencave të përgatitet sipas dispozitave të ligjit “Për emergjencat civile”.

h) Përmbledhjen joteknike (në gjuhë dhe terminologji lehtësisht të kuptueshme) të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili përmban informacion të përmbledhur për çdo çështje të trajtuar në raportin e VNM-së. Për lehtësi praktike dokumenti duhet të dorëzohet edhe elektronikisht në format PDF.

2.4 Vendimin/mendimin e këshillit të bashkisë apo komunës për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e tyre.

2.5 Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit për lejen mjedisore sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës.

3. Ky udhëzim duhet t’u shpjegohet kërkuarve të lejes mjedisore dhe t’u vihet në dispozicion që të përgatisin saktë dhe në kohë sa më të shkurtër dokumentet për të kërkuar leje mjedisore.

4. Për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtoria e mbrojtjes së mjedisit;

5. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzim nr.1, datë 7.1.2008 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu